

VENDIM
Nr. 221, datë 23.10.2024

**MBI KËRKESËN E SHOQËRISË “ALBESP TRADING & CONSULTING” SHPK,
PËR DHËNIEN E AUTORIZIMIT NGA ERE PËR NDRYSHIMIN E ORTAKUT QË
KONTROLLON INTERESAT E SAJ**

(Ndryshuar me vendimin nr. 46, datë 27.2.2025)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; neneve 5, 7 dhe 10 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie e autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit, ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit dhe vendosjen e kuotave/aksioneve të ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 235, datë 26.11.2021; si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 23.10.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1628/8 prot., datë 21.10.2024, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve “Mbi kërkesën e shoqërisë “AlbEsp Trading & Consulting” sh.p.k. për dhënie e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e saj”,

konstatoi se:

- Shoqëria “AlbEsp Trading & Consulting” sh.p.k. është licencuar në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 241, datë 2.12.2021, si dhe në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 242, datë 2.12.2021.

- Me shkresën nr. 144 prot., datë 12.7.2024, protokolluar në ERE me nr. 1628 prot., datë 12.7.2024, shoqëria paraqiti kërkesë dhe dokumentacion për marrjen e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e saj.

- Pas shqyrtimit paraprak të kërkesës dhe dokumentacionit bashkëlidhur, ERE iu drejtua shoqërisë me shkresën nr. 1628/1 prot., datë 2.8.2024, duke i evidentuar informacionin/dokumentacionin e munguar për aplikimin e saj.

- Në përgjigje, me shkresën nr. 1628/2 prot., datë 19.8.2024, shoqëria ka plotësuar dokumentacionin e kërkuar, nga shqyrtimi i të cilit ka rezultuar se ka nevojë për depozitim informacioni të dokumentacionit shtesë, ndaj ERE iu drejtua shoqërisë me shkresën nr. 1628/3 prot., datë 30.8.2024.

- Në përgjigje, me shkresat e protokolluara në ERE me nr. 1628/4 prot., datë 4.9.2024, si dhe me *email*-in e datës 8.10.2024 të protokolluar në ERE me nr. 1628/7 prot., shoqëria ka plotësuar dokumentacionin e munguar.

- Pas analizimit të kërkesës dhe të dokumentacionit të përcjellë nga shoqëria me korrespondencën vijuese të realizuar me ERE-n, rezulton se ajo ka plotësuar tërësisht dokumentacionin e kërkuar në nenin 7 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie e autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit, ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit dhe vendosjen e kuotave/aksioneve të ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 235, datë 26.11.2021.

- Shoqëria “AlbEsp Trading & Consulting” sh.p.k. nuk ka detyrime të pashlyera ndaj ERE-s për sa u përket pagesave të rregullimit.

- Dhënia e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e shoqërisë “AlbEsp Trading & Consulting” sh.p.k. nuk e çliron këtë të fundit nga detyrimi për të marrë

autorizimin/miratimin e organeve të tjera apo të palëve të treta për këtë ndryshim, në rast se kjo kërkohet nga këto organe.

- Shoqëria duhet të depozitojë në ERE marrëveshjen e nënshkruar për shitblerjen e kuotave brenda datës 31.12.2024.

- Në referencë të përcaktimeve të nenit 9, pika 8, të rregullores, shoqëria duhet të depozitojë në ERE ekstraktin historik të regjistrit tregtar brenda 10 (dhjetë) ditëve nga reflektimi në të i ndryshimit të ortakut që kontrollon interesat e saj.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e shoqërisë “AlbEsp Trading & Consulting” sh.p.k.

2. Ortaku që kontrollon interesat e shoqërisë “AlbEsp Trading & Consulting” sh.p.k. bëhet znj. Eni Hasanbelliu.

3. Dhënia e autorizimit nga ERE, për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e shoqërisë “AlbEsp Trading & Consulting” sh.p.k., nuk e çliron këtë të fundit nga detyrimi për të marrë autorizimin/miratimin e organeve të tjera apo të palëve të treta për këtë ndryshim, në rast se kjo kërkohet nga këto organe.

4. *Shfuqizuar.*

5. *Shfuqizuar.*

6. *Shfuqizuar.*

7. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve të njoftojë shoqërinë “AlbEsp Trading & Consulting” sh.p.k. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi, apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti